



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:194201
Datë: 29.07.2024
Numri i dokumentit: 05994524

Ac.nr.3580/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj, kryetare e kolegjit, Faton Ademi dhe Besnik Bislimaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit E.LL nga fshati ..., Komuna e Lipjanit të cilin me autorizim e përfaqëson S.K, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Drejtësisë, në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, me bazë juridike diskriminimin dhe kompensimin e pagave jubilarë, vlera e kontestit 504.00 euro, duke vendosur në lidhje me ankesën e paditësit të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.7316/2021, i datës 31.01.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.07.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditësit E.LL nga fshati ..., Komuna e Lipjanit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.7316/2021, i datës 31.01.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.7316/2021, i datës 31.01.2022, ka vendosur që në pikën I (një) të dispozitivit e ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit E.LL nga fshati ..., Komuna e Lipjanit, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet diskriminimi ndaj paditësit dhe të detyrohet e paditura që paditësit, në emër të shpërblimit jubilar, t'ia paguajë një pagë mujore neto në shumë prej 504.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e ushtrimit të padisë, deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm, si e pabazuar.

Në pikën II (dy) të dispozitivit ka vendosur që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur përfaqësuesi i autorizuar i paditësit për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovojë si të bazuar ankesën e të paditurës, ndërsa aktgjykimin e atakuar ta prishë apo të njëjtën ta kthejë në rigjykim ose ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar, duke e aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, po ashtu i ka kërkuar shpenzimet e procedurës, si dhe shpenzimet për përpilimin e ankesës në vlerë 208 euro, dhe taksën gjyqësore për ankesë 31 euro, të gjitha këto sipas Tarifës së Avokatëve TOA.

Ankesa e paditësit i është dorëzuar të autorizuarit të së paditurës, por e njëjta nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarit të tij me datë 12.08.2021 në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi për diskriminim dhe kompensim të pagave jubilarë, me arsye si në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, si dhe të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.7316/2021 të datës 31.01.2022, me të cilin e ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se paditësi ka themeluar marrëdhënie pune me të paditurën nga data 01.08.2003.

Gjykata gjen se me dispozitat e nenit 90 par.4 të Ligjit të Punës, përcaktohet se: “ *Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet, andaj zbatimi i kësaj marrëveshje ka përfunduar pas kalimit të afatit tre vjeçar të hyrjes së saj në fuqi e që është data 31.12.2017. Pasi që paditësi ka themeluar marrëdhënie pune me të paditurën me datë 01.08.2003 me kohë të pacaktuar, gjykata vlerëson se i njëjti vitin jubilar të dhjetë (10) e ka përmbushur me datë 01.08.2013, para hyrjes në fuqi të MKK-së.*

Paditësit i ka lindur e drejta për shpërblim jubilar nga data 01.01.2015, kurse me padi i është drejtuar gjykatës më 11.08.2021, e nga kjo rezulton se kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës, ku me nenin 87 të Ligjit të Punës, parashihet se: “ *Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh nga data e paraqitjes së kërkesës.* ” Andaj gjykata refuzoi një kërkesë të tillë.

Sa i përket kërkesëpadisë që ka të bëjë me vërtetimin e diskriminimit ndaj paditësit, gjykata ka vlerësuar se kërkesëpadija për diskriminim është e pathemeltë, meqenëse kërkesa për shpërblim jubilar është parashkruar dhe baza e kërkesëpadisë për diskriminim ndaj paditësit ndërlihet me kërkesëpadinë për shpërblim jubilar, sepse paditësi si shkak për ekzistimin e diskriminimit ndaj tij pretendon mos pagesën e shpërblimit jubilar nga e paditura.

Gjykata e shkallës së parë është bazuar në dispozitat e nenit 399 të LPK-së, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në shkeljet nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit. Aktgjykimi është i drejtë dhe i ligjshëm dhe në arsyetimin e aktgjykimit janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse lidhur me faktet thelbësore, provat e administruara dhe zbatimin e të drejtës materiale.

Është i pabazuar pretendimi ankimor për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike për faktin se gjykata e shkallës së parë mbi bazën e fakteve jo kontestuese si dhe provave të administruara drejtë ka vërtetuar se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura nga data 01.08.2003 dhe se Gjykata e Apelit, pas ekzaminimit të aktgjykimit të atakuar ka ardhur në përfundim se nga vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është zbatuar edhe drejtë e drejta materiale. Paditësi nuk i është drejtuar të paditurës me kërkesë për realizimin e pagës jubilarë e poashtu gjykatës nuk i është prezantuar asnjë dokument ose kërkesë me të cilën paditësi i është drejtuar të paditurës për realizimin e pagës jubilarë, e cila do ta ndërpriste afatin e parashkrimit, ndërkaq padinë e ka paraqitur në gjykatë të shkallës së parë me datë 12.08.2021, e që rezulton se kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesëpadisë, pasi që bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës parashihet se “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.” Bazuar në gjendjen faktike paditësi ka themeluar marrëdhënie pune me të paditurën me datë 01.08.2003 me kohë të pacaktuar, gjykata vlerëson se i njëjti vitin jubilar të dhjetë (10) e ka përmbushur me datë 01.08.2013, para hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Gjithashtu duke u bazuar në nenin 357 par. 1 i LMD-së, në të cilin citohet se “Kërkesa për shpërblim të dëmit të shkaktuar parashkruhet për 3 vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijani për dëmin dhe për personin e cili ka shkaktuar dëmin”, i bie se këtu paditësit me hyrjen në fuqi të MPKK datë 01.01.2015 iu është njohur e drejta për të paraqitur kërkesën e tij, andaj si datë e fundit do të kishte qenë data 31.12.2017, që nënkupton se ushtrimi i padisë në gjykatë nga ana e paditësit në gusht të 2021 rezulton se ka kaluar afati i paraparë ligjor dhe se kërkesëpadia e paditësit është parashkruar. Sa i përket çështjes së diskriminimit, kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar kur ka konstatuar se, kërkesëpadia për diskriminim ndaj paditësit ndërlidhet me kërkesëpadinë për shpërblim jubilar, sepse paditësi si shkak për ekzistimin e diskriminimit ndaj tij pretendon në mos pagesën e shpërblimit jubilar nga e paditura, andaj meqenëse kërkesa e paditësit për shpërblim jubilar është parashkruar atëherë në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me diskriminim ndaj paditësit.

Gjykata i mori për bazë të gjitha pretendimet ankimore të paditësit, por të cilat nuk kishin ndikim për të vendosur ndryshe se si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.3580/2022 me datë 25.07.2024

Kryetare e kolegjit
Hidajete Gashi Alaj, d.v.